MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL - DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Nr. 020-649/8
Data 16.11.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo za Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt<br>Kristina Gashi Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Ferizajt | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MPL-së | |
| Nga: | Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MPL | Date: 12/11/2020<br>Nr. 020-649 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa. Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit<br>Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së Ferizajt | |
| Lloji i aktit: | Vendimit | |

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregullores e QRK-së Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullore (QRK) nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë se Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 80 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimit nr.118 për anulimin e vendimit nr.96 të datës 31.08.2020 të kuvendit të komunës se Ferizajt |
| I miratuar më datë: 30.10.2020 |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 04.11.2020 |

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës <u>**është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**</u> dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

ALAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-649/8 VI
Data Datum Date 16.11.2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Agim Aliu, gradonačelnik opštine Uroševac<br>Kristina Gashi Bytyqi, predsedavjuća Skupštine opštine Uroševac | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-a<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS-a,<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MLS-a, | |
| Od: | Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MLS | Datum, 12.11.2020. br.020-649 |
| Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene: | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština | |
| Službenik-ca za izradu pravne procene: | Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Uroševac | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine | |

Uvaženi gradonačelniče,
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akata opštine kako je predviđeno članom 80. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka br.118 o ukidanju Odluke br.96 od dana, 31.08.2020. godine, Skupštine opštine Uroševac |
| Usvojena dana, 30.10.2020. godine |
| Predložena na razmatranje u MLS-u dana, 04.11.2020.godine |

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt aspektu u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi.

Ministartsvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 118
Datë: 03.11.2020

Bazuar në nenin 12, paragrafin 12.2 pika d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03 L- 040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenin 53, paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L 03, nenit 10 paragrafit 2 pika 2.4 dhe nenit 25 paragrafit 2.11 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013 Kuvendi i Komunës së Ferizajt, në seancën e mbajtur me datën. 30.10.2020 miratoi:

## VENDIM
## PËR ANULIMIN E VENDIMIT 01. NR. 96 TË DATËES 31.08.2020 TË KUVENDIT TË KOMUNËS

I

**ANULOHET:** Vendimi i Kuvendit të Komunës 01.Nr. 96 të datës 31.08. 2020 për lirimin e qytetarëve nga kushtëzimi i pagesës së tatimit në pronë për regjistrimin e veturave për vitin 2020.

II

Bazë kryesore për anulimin e vendimit të Kuvendit Komunës 01.Nr.96 të datës 31.08. 2020 është kërkesa nr.1483-1 e datës 01.09.2020 nga MF për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të Komunës.

III

Qëllimi i anulimit të vendimit të cekur në pikën I të këtij vendimi është implementimi i vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të Komunës nr. 1483-1 të datës 01.09.2020 të Ministrisë së Financave me të cilin konstatuar se vendimi i KK-së 01 Nr. 96 të datës 31.08.2020 është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe si tillë nuk mundë të zbatohet.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesuese e Kuvendit të Komunës

Kristina Gashi Bytyçi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Br. 118
Datum: 03.11.2020

Na osnovu člana 12. stav 12.2 tačka d Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03 / L-040. (Službeni list Republike Kosovo br. 28/2008). član 53. stavovi 1 i 3 Zakona o opštem upravnom postupku br. L 03, član 10 stav 2 tačka 2.4 i član 25 stav 2.11 Statuta opštine Uroševac 01 Br. 50 od 28.08.2015 Skupština opštine Uroševac je na sednici održanoj 30.10.2020 usvojila je:

## ODLUKA
## O PONIŠTENJU ODLUKE 01. BR. 96 OD 31.08.2020. SKUPŠTINE OPŠTINE

I

**PONIŠTAVA SE:** Odluka Skupštine opštine 01.br. 96 od 31.08. 2020. godine za oslobađanje građana od uslovljavanja plaćanja poreza na imovinu za registraciju automobila za 2020. godinu.

II

Glavni osnov za poništaj odluke Skupštine opštine 01 br. 96 od 31.08. 2020 je zahtev br. 1483-1 od 01.09.2020 Ministarstva finansija za ocenu zakonitosti akata opštine.

III

Svrha poništavanja odluke iz tačke I ove odluke je sprovođenje ocene zakonitosti akata Opštine br. 1483-1 od 01.09.2020 Ministarstva finansija koje je zaključilo da je odluka SO 01 br. 96 od 31.08.2020. u suprotnosti sa važećem zakonodavstvu i kao takva se ne može primeniti.

IV

O sprovođenju ove odluke pobrinuće se: gradonačelnik opštine i Direkcija za finansije.

V

Ova odluka stupa na snagu 15 dana od registracije u Kancelariji za protokol ministarstva nadležnog za lokalnu samoupravu i objavljivanja na službenom jeziku na veb stranici opštine.

Predsedavajuća Skupštine opštine

Kristina Gashi Bytyçi

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Financave – Ministarsvo za Finansije*
*Ministry of Finance*

| | |
|---|---|
| Për: | Goran Rakić, Ministër i Pushtetit Lokal<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme, MPL |
| Kopje: | Kryetari i Komunës së Ferizajt<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL |
| Përmes: | Agim Krasniqi, Zv. Ministre e Ministrisë së Financave<br><br>Enis Spahiu, Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave |
| Nga: | Bahrije Berisha, Zv. Drejtoreshë i Departamentit Ligjor Data: 17.09.2020<br>Ministria e Financave |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari kontinues i vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari kontinues i vlerësimit ligjor | Razije Murtezaj, Departamentit Ligjor Referenca: 29<br><br>Lumnije Hetemi, Departamenti i Tatimit në Pronë |
| Lënda: | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Ferizajt |
| Lloji i aktit: | **Vendimi i Komunës së Ferizajt, për lirimin nga kushtëzimet e pagesës së tatimit në pronë për regjistrim të veturave për vitin 2020 me 01. Nr.96 i datës 02.09.2020** |

I nderuar Ministër, z. Rakic,
E nderuara Sekretare e Përgjithshme, znj. Ukimeraj,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

- Vendimi i komunës së Ferizajt, për lirimin nga kushtëzimet e pagesës së tatimit në pronë për regjistrim të veturave për vitin 2020 me 01.Nr.96 i datës 02.09.2020

I miratuar me datë: 31.08.2020.
I parashtruar për shqyrtim në MPL me datë: 02.09.2020
I dërguar për shqyrtim në MF me datë: 07.09.2020.

Ministria e Financave pas shqyrtimit në përmbajtjesor të aktit komunal vlerëson se pezullimet e shërbimeve komunale janë të rregulluara me Ligjit Nr. 06/L-005 Për Tatimit në Pronën e Paluajtshme në nenin 29 [Pezullimi i shërbimeve komunale] si dhe kushtëzimet lidhur me pezullimin e shërbimeve komunale janë të rregulluara me Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë.

Neni 5 i UA - Nr. 07/2011 thotë: "1. *Taksa për regjistrim të automjeteve motorike. Komunat kërkojnë nga qytetarët/bizneset që të paguajnë taksën për pronësinë e automjeteve motorike brenda kufijve të komunës. Komuna nuk duhet ti kryej këto shërbime për derisa nuk është paguar tatimi në pronë*".

Vendimi i komunës së Ferizajt për lirimin nga kushtëzimet e pagesës së tatimit në pronë për regjistrim të veturave për vitin 2020 me 01.Nr.96 i datës 02.09.2020. nuk është në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-005 Për Tatimit në Pronën e Paluajtshme dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë.

Andaj nga dispozitat e cekura më lartë, Ministria e Financave vlerëson se ky vendim është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë nuk duhet të zbatohet.

Me respekt!